



PARTIA SHQIPTARE DEMOKRISTIANE E KOSOVËS
THE ALBANIAN CHRISTIAN DEMOCRATIC PARTY OF KOSOVA
ALBANISCHE CHRISTLICH-DEMOKRATISCHE PARTEI VON KOSOVA
PARTITO ALBANESE DEMOKRISTIANO DI KOSOVA
LE PARTI ALBANAIS DEMOKRATE-CHRETIEN DE LA KOSOVA

Organ i aktivistëve dhe intelektualëve demokristianë në Vjenë

BULETIN INFORMATIV Nr. 3- dhjetor 2010

del një herë në 3 muaj

shpërndarja: pa pagesë

„Dielli i shqiptarëve lind në perëndim” (Faik Konica)

DIELLI DEMOKRISTIAN



Shkrime:

Institucioni i familjes
Kohë e Burgosur ...
Rini-Ardhmëria e Kombit
Siguri apo paqe e ftohtë?!
Heshtja
Femra dhe emancipimi
Thuaj po shtetit
Martirët e famullisë së Smaqit

1

Info nga PSHDK
Ditët e Nënës Tereze në Vjenë

Intervistat: ju prezentojmë ...
Shoqata „Nënë Tereza” nga Baden (Austri)
Faqja historike
Këndi kulturor



URIME DITËN E FLAMURIT

PËR SHUMË MOTE KRISHTLINDJET!

GËZUAR VITIN E RI!



FJALA E REDAKSISË

Të nderuar lexues,

Revista „DIELLI DEMOKRISTIAN", duke qenë organ i aktivistëve dhe intelektualëve demokristianë në Vjenë/Austri prapë sjellë informacione, raporte, shkrime, analiza dhe artikuj interesantë. Pas daljes e numrin të dytë, këshilli redaktues mori shumë përgëzime për punën e bërë, ndër të cilat këtë herë po veçojmë: Gjon Keka, Gjevat Balaj, Vinçenc Palushi, Kolë Berisha (Austri), Marjan Dema, Mhill Shala, Robert Marjakaj, Gegë Lleshi (Kosovë), Luz Thaçi, Agron Jetishi, Pjetër Coli (Gjermani), Kolë Markaj (Zvicërr), Gjon Nikollaj, Leke Përlleshi (SHBA), Agron Ndrecaj (Çeki) etj.

Në tre muajt e fundit kishte zhvillime dhe aktivitetet të shumta organizuar nga komuniteti shqiptar në Austri. Fillimisht, në fund të gushtit u zbulua shtatorja e Nënës Tereze në qytetin e Graz-it, për të vazhduar me „Javën e Nënës Tereze" në Vjenë, implementuar nga Misioni Katolik Shqiptar në Austri. Në Kosovë, me rastin e inaugurimit të katedrales në kryeqendër, PSHDK organizoi Marshin e Paqes në të gjitha qytetet që kanë shtatore të Nënës Tereze. Me 10 tetor 2010 u mbajtën zgjedhjet në Vjenë, në të cilat edhe komuniteti shqiptar, për herë të parë, u përfaqësua me disa kandidatë. Një delegacion i lartë i PSHDK, udhëhequr nga kryetari i saj, prof. dr. Marjan Dema zhvilloi një vizitë zyrtare në Austri (21-22 tetor 2010), ndërsa në fund të tetorit, në një meshë madhështore, Misionin Katolik Shqiptar e vizitoi shkelqësia e tij, Kardinali i Vjenës, Christoph Schoborn. Në ndërkohë, me 12 dhjetor të këtij viti në Kosovë do të mbahen zgjedhjet e parakohëshme parlamentare, të cilat urojmë të zhvillohen në frymë demokratike, duke besuar se PSHDK prapë do të përfaqësohet denjësisht në institucionet më të larta shtetërore.

Në këtë botim të „DIELLIT DEMOKRISTIAN" do të gjeni materiale me interes për rrjedhat e përgjithshme në shoqëri, jetën politike në Kosovë dhe diasporë. Numri i atyre që me shkrimet e tyre kanë kontribuar këtë herë, në krahasim me numrin e parë, është trefishuar. Sidomos ka shënuar përparim të theksuar paraqitja me artikuj e gjinisë femërore. Nga numri tjetër revistën tonë dhe tuajën do ta pasurojmë edhe me dy rubrika të reja: TAKT (Tema AKTuale) dhe OPILEX (OPinionet e LEXuesve). Në rubrikën e parë, si temë diskutimi do kemi dilemën: -A mendoni se partitë shqiptare duhet të kenë degët e tyre edhe në diasporë?. Ndërsa në rubrikën e dytë, nga tani e tutje do të kemi faqen e posaçme për lexues ku ju mund të na shkruani lidhur me pyetjet, vërejtjet dhe sugjerimet tuaja në adresën e e-mail-it: dielli-demokristian@hotmail.com apo dielli-demokristian@hotmail.com të cilave do tu përgjigjemi në numrin e radhës të kësaj reviste, e cila pritet të dalë prapë në mars të vitit të ardhshëm. Në të ardhmen, do dëshironim të kemi autorë jo vetëm nga Austria dhe Kosova, por edhe nga Shqipëria, vendet tjera të banuara me shqiptarë në Ballkan, si dhe nga diaspora. Poashtu vizioni ynë është që të profilizohemi edhe më tej, duke pasur edhe faqe të analizës politike, ekonomike, kolumne, ese, shkrime nga fusha e shëndetësisë, kulturës, sportit, etj.

Këshilli redaktues falënderon të gjithë ata që ndihmuan në botimin e kësaj reviste periodike, e në veçanti ata që dërguan shkrimet e tyre, si dhe mbështetësit tanë moral. Edhe ky numër është pëpiluar, dizajnuar dhe botuar në saje të punës dhe angazhimit vullnetar të aktivistëve tanë pa asnjë kompenzim financiar, dhe si i tillë do shpërndahet në adresat elektronike të lexuesve tanë në të katër anët e botës.

Lexim të këndshëm!

Këshilli redaktues:

Kristina Pjetri
Mark Gjuraj
Vilson Kola
Lush Neziri
Mark Marku

Bashkëpunëtorë të jashtëm:

Hazir Mehmeti
Agron Shala
Anita Marku
Shtjefën Daka
Zef Ndrecaj
Valentina Pjetri
Xhenc Bezhi

“Me gjak jam shqiptare; me nënshtetësi, indiane. Përsa i përket besimit, jam murgeshë katolike. Sipas thirrjes, i përkas botës. Por zemra ime i përket plotësisht Zembrës së Krishtit”.

(Nënë Tereza)

Nënë Terezës, me shtat imcak, por me besim shkëmbor, të patundur, iu besua misioni të kumtonte dashurinë e etur të Jezusit për njerëzimin, veçanërisht për më të varfërit ndër të varfër. *"Hyji vijon ta dojë botën dhe na dërgon ty e mua për t'u shprehur të varfërve dashurinë dhe mëshirën e Tij"*. Në shpirtin e saj, përplot me dritën e Krishtit e me dashuri të zjarrtë për Të, kishte një dëshirë të vetme : *"Të shuante etjen e dashurisë së Tij për shpirtrat njerëzore"*.

Përmbajtja:

Ditët e Nënës Tereze në Vjenë.....	3
Info nga PSHDK.....	4
Blic info	5
Nënë Tereza: I desha njerëzit	6
Institucioni i familjes.. ..	7
Kohë e Burgosur	8
Intervista: Agron Shala	9
Intervista: Valentina Pjetri.....	10
Rini-Ardhmëria e Kombit	11
Siguri apo paqe e ftohtë?.....	12
Heshtja.....	12
Femra dhe Emancipimi.....	13
Thuaj po shtetit	14
Telegram urimi	14
Eshtnat e At Gjergj Fishtës.....	15
Martirët e famullisë së Smaqit.....	16
Këndi kulturor	17

U përbyll me sukses aktiviteti „Ditët e Nënës Tereze“ në Vjenë (26 gusht-5 shtator 2010)

Me një meshë solemne, me 5 shtator 2010 në Vjenë, Misioni Katolik Shqiptar në Austri, nën udhëheqjen e Don Pren Kolës përmbylli me sukses projektin „Ditët e Nënës Tereze“ me rastin e shënimit të 100 vjetorit të lindjes së saj. Ky manifestim u pasurua edhe me një program të përzgjedhur artistik. Përndryshe, aktiviteti i parë në kuadër të këtij projekti filloi të dielen, me 29 gusht me hapjen e ekspozitës me fotografi, libra, piktura dhe punime tjera kushtuar Nënë Terezës, i cili u mbajt nën partonatin e Ambasadorit të Kosovës në Vjenë, Dr. Sabri Kiqmarit, i cili bëri dhe hapjen zyrtare.



Kjo ekspozitë përbëhej nga mëse 140 libra kushtuar Nënë Terezës në gjuhë të ndryshme të botës dhe nga më shumë se 30 fotografi që përshkruajnë besnikërisht jetën dhe veprën e saj. Ajo qëndroi e hapur për një javë tërë dhe u vizitua nga qindra dashamirë të artit. Dy ditë më pas u organizua një takim me fëmijët, i cili u përcoll me lutje, uratë, adhurim dhe prezentim vizuel të jetës dhe veprës së Nënë Terezës. Me 2 shtator para studentëve dhe intelektualëve nga kombe të ndryshme të botës në Fakultetin Juridik të Universitetit të Vjenës, prof. dr. Anton Nikë Berisha ligjëroi në tribunën shkencore me temën „Nëna Tereza

dhe shqiptarët“, prezentim ky që u



prit me një interes të theksuar.

Një ditë më vonë, u mbajt koncerti me muzikë klasike të në të cilin performuan me shumë sukses studentët shqiptarë në akademinë e



muzikës në Vjenë.

Programi vazhdoi me 4 shtator kur u bë promovim i pesë librave dhe një albumi monografik. Para një audience të veçantë u prezentuan librat për Nënë Terezen „Thellimi në dashuri“ dhe „Alfabeti i Nënë



Terezës“, ky i dyti me autor Don Pren Kolën. Gjithashtu nga një fjalë rasti u mbajt edhe për veprat „PSHDK-bartëse e veprimtarive politike, kulturore e kombëtare në Austri“ (Prekë

Brahimi), „Tregime nga Malësia e Gjakovës“ (Xhenc Bezhi) dhe „Vizioni Blu“ (Anton Marku). Në këtë mbrëmje të letërsisë dhe kulturës u paraqit edhe një album fotografish me veshje kombëtare nga Rrafshi i Dukagjinit, ndërsa lidhur me të referoi Flora Balaj.

Vlen të theksohet se pjesa më e madhe e donacioneve për këtë manifestim një javor u grumbullua nga donatorët vullnetmirë nga radhët e komunitetit, ndërsa i tërë angazhimi dhe puna u bë në mënyrë vullnetare nga aktivistët e Misionit Katolik Shqiptar në Austri.

INFO NGA PSHDK

Kryetari i PSHDK, Marjan Dema përfundoi vizitën zyrtare në Austri

Vjene, 21-22 tetor 2010: -Në vazhdim të aktiviteteve për vendosjen e kontakteve me partitë simotra në Evropë, një delegacioni i lartë i PSHDK, i përbërë nga kryetari Marjan Dema, anëtari i kryesisë qendrore, Pjetër Coli dhe kryetari i degës së kësaj partie në Vjenë, Vilson Pepaj, qëndroi këto ditë në Austri. Fillimisht delegacioni i lartë nga Kosova u prit nga përfqësues të Partisë Popullore të Austrisë (ÖVP), e cila është edhe pjesë e koalicionit qeveritar në Austri. Prof. Dr. Marjan Dema njoftoi të pranishmit për programin dhe vizionin e PSDHK, si një ndër partitë më me traditë në skenën politike kosovare. Nikoqiri i këtij takimi, Wolfgang Großruck, anëtar i parlamentit austriak dhe ekspert për Ballkanin Perëndimor thekoi se partia e tij është e interesuar që të ndihmojë zhvillimet demokratike në Kosovë.



Patrick Voller, sekretar për marrëdhënie me jashtë i OVP premti se do të shikohet për mundësinë e përkrahjes së kërkesës së PSHDK për anëtarësim

në Unionin Evropian të Partive Popullore. Monika Reiner, e ngarkuar me çështjet evropiane në OVP morri përsipër shqyrtimin e mundësisë së ngritjes së kapaciteteve të rinjve demokristianë të Kosovës përmes trajnimeve në akademinë politike të partisë që ajo përfaqëson. Takimi i dytë u zhvillua me Matthias Tschirf, udhëheqës i klubit të këshilltarëve të Partisë Popullore në Parlamentin e Vjenës, i cili pos tjerash, u shpreh i gatshëm që një ekip i OVP të vizitonte PSHDK gjatë fushatës së ardhshme zgjedhore, duke ofruar ndihmë për organizimin sa më të mirë të fushatës elektorale, duke sjellë me vete përvojat që ka kjo parti me renome evropiane. Ai poashtu propozoi vendosjen e kontakteve të rregullta me degën e PSHDK në Vjenë, në mënyrë që të shfrytëzohet ky potencial për të mirën e një integrimi kuptimplotë të demokristianëve shqiptarë në jetën politike dhe shoqërore të Austrisë.

PSHDK kërkon nga Vatikani të njohë Pavarësinë e Kosovës

Në takimin me një nga përfaqësuesit e Misionit të Papës në Austri, Eugen Waldstein, kreu i PSHDK Marjan Dema, kërkoj që Vatikani të fillojë shqyrtimin e mundësisë së njohjes së shtetit të Kosovës, duke u rreshtuar kështu në grupin e atyre vendeve të cilat kanë njohur vullnetin e popullit të Kosovës për liri, pavarësi dhe shtet

demokratik. Nga ana e nikoqirit u premtua se kjo kërkesë do t'i përcillet përmes kanaleve zyrtare Selisë së Shenjtë. Vizitën zyrtare në Austri delegacioni i lartë i PSHDK e përfundoi me takimin me Raimund Badelt, përgjegjës për projektet ndërkombëtare të Caritas-it austriak, në të cilin PSHDK falënderoi këtë insitucion për gjithë angazhimin dhe ndihmën që ka ofruar në Kosovë përgjatë dy dekadave të fundit.



Në takim u bisedua edhe për projektet të cilat tashmë po zbatohen në Kosovë, si dhe për angazhimin e aktivistëve demokristianë në Vjenë në programe të ndryshme që kjo organizatë zhvillon në Vjenë.

Delegacioni i lartë i PSHDK poashtu u prit në një takim të veçantë edhe nga Ambasadori i Kosovës në Austri, Sabri Kiqmari, ndërsa në të gjitha takimet zyrtare ky delegacion u shoqërua nga një përfaqësues i Ambasadës sonë.

Qendra për Informim e PSHDK

Blic Info

Inaugurohet shtatorja e Nënës Tereze në Graz të Austrisë

Shoqëruar me një program të përzgjedhur kulturo-artistik, me 27 gusht 2010 në Graz u bë përvendimi i shtatorës së Nënës Tereze. Në këtë ceremoni, pos mysafirëve të shumtë, morën pjesë edhe Ministri për Kulturë i Kosovës Lutfi Haziri, diplomatë nga Ambasadat e Shqipërisë dhe Kosovës, si dhe akademikë dhe politikanë austriakë.



Kandidatët shqiptarë në zgjedhjet në Vjenë

Me 10 tetor 2010 u mbajtën zgjedhjet për Asamblenë Krahinore dhe Këshillin Komunal të Vjenës. Në mesin e shumë kandidatëve, kësaj radhe konkuruan edhe dy shqiptarë: Januz Saliuka (nga Gjakova), nën siglën e Partisë Socialdemokrate të Austrisë dhe Arbër Marku (nga Dibra) në listën e Partisë Popullore të Austrisë. Edhe pse asnjëri prej tyre nuk arriti të grumbullojë numrin e nevojshëm të votave për të siguruar një ulësë në asamblenë e Vjenës, ata thyen tabunë se shqiptarët nuk mund të integrohen në jetën politike dhe shoqërore në Austri. Këshilli redaktues i revistës „DIELLI DEMOKRISTIAN" i përgëzon sinqerisht që të dy ata për përkushtimin e treguar, dhe ju dëshiron më shumë suksese në zgjedhjet e ardhshme.

Mihrije Rushani fiton çmimin e personalitetit të vitit

Të dielën, me 10 tetor 2010, në Gemeindesaal Pfaffstätten afër Vjenës, u mbajt ceremonia e ndarjes së çmimit "Weltmensch" (person botëror), çmim i cili ndahet çdo vit nga organizata "Weltmensch" në bashkëpunim me shoqatën humanitare „Nënë Tereza" nga qyteti i Baden-it në Austri. Këtë vit laureat i çmimit ishte znj. Mihrije Rushani, ish-Ambasadore e Maqedonisë në Itali dhe veprimtare e palodhur humanitare.



Përveq bashkëatdhetarëve të shumë shqiptarë, si dhe qytetarëve austriakë, të pranishëm në këtë solemnitet ishin edhe Ambasadori i Kosovës në Vjenë z. Sabri Kiqmari, Sekretari i Parë i Ambasadës së Shqipërisë z. Egin Ceka, si dhe përfaqësues të komunës së Baden-it. Pas ceremonisë së ndarjes së çmimit, u dha edhe një program i shkurtër kulturo-artistik me këngë e valle shqiptare.

Kardinali i Vjenës, Christoph Schonborn vizitoi Misionin Katolik Shqiptar në Austri

Me 31 tetor 2010, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët, në meshën madhështore në të cilën morën pjesë rreth 500 bashkëkombas tanë, Misionin Katolik Shqiptar në Austri e vizitoi Shkelqësia e tij, Kardinali i Vjenës, Christoph Schonborn.



Kremtohet 28 nëntori-Dita e Flamurit

Edhe këtë vit, shoqata të ndryshme shqiptare festuan Ditën e Kombit-Ditën e Flamurit. Në Vjenë, Baden, Graz, Linz, Wiener Neustadt, etj, jehuan këngët dhe vallet nga tradita jonë. Pos përfaqësuesve të korit diplomatik në këto organizime morën pjesë edhe mysafirë austriakë.



Kumtesa nga prof. dr. Anton Nikë Berisha, lexuar në tribunën shkencore, në kuadër të aktiviteteve „Ditët e Nënës Tereze”, mbajtur në fakultetin juridik të Univerzitetit të Vjenës, me 3 shtator 2010

Nënë Tereza: I desha njerëzit me dashurinë e Hyjit

(Përmbledhje e shkurtër: *pjesa e parë*)

Nëna Tereze ishte dhe mbetet një shembull i rrallë në historinë e njerëzimit për dashurinë që tregoi për Hyjin dhe për dashurinë dhe flijimin që bëri për njeriun, sidomos për më të varfrit, për fëmijët jetimë e për të braktisurit. Ajo zbatoi me përpikëri urdhrin e Ungjillit: “*Duajeni njëri – tjetrin sikurse unë ju desha juve*” (Gjn 13, 34) dhe “*Duaje të afërmin tënd porsi vetveten!*” (Mt 22, 39).

Nëna Tereze iu përkushtua Zotit dhe dashurisë së tij me gjithë qenien e saj me qëllim që, po me atë dashuri, t’i donte njerëzit dhe të kujdesej për ta. Ajo ishte e bindur se Hyji është krijues i çdo qenieje dhe se jeta njerëzore në qenësi “*është vetë jeta e Zotit në ne*”.

Shkrimtari dhe gazetari i shquar anglez, që, ndër të parët, e bëri të njohur në mënyrë të denjë punën e Nënës Tereze dhe të *Misionareve të Dashurisë* jashtë Indisë, Malcolm Muggeridge, në bisedën “historike” që e bëri me Nënë (për BBC) theksoi ndër të tjera “Duke e mohuar vetveten, ajo do ta gjejë vetveten”, përkatësisht, “Duke hequr dorë nga vetvetja, ajo bëhet e vetvetes”.

Me besimin në Hyjin dhe me veprimin e vet të nxitur prej Tij, Nëna Tereze u bë krejtësisht e Hyjit dhe u shndërrua në vegël të Tij: “Gjithçka që bëjmë e bën Zoti nëpërmjet nesh”.

Për të konkretizuar rëndësinë e jashtëzakonshme të veprës dhe të figurës së Nënës Tereze po përmend mendimin e kryepeshkvit të Kalkutës, mons. Henry D’ Souza: “*Po, India e ka ndryshuar Nënë Tereze, duke e detyruar me dhunën e varfërisë, ta përfillë çështjen e të varfërve nga më të varfrit. Mirëpo edhe Nëna Tereze e*

ka ndryshuar Indinë, duke e kundërshtuar mentalitetin fatalist dhe duke e rivendosur vlerën e pazëvendësueshme të individit”.

Nëna u kushtoi kujdesin e jashtëzakonshëm të varfërve nga më të varfrit sipas përcaktimit ungjillor: “*Të lumtë ju, o skamnorë, sepse juve ju përket Mbretëria e Hyjit*” (Lk 6, 20; 14, 13 – 14; Mt 5, 3), mirëpo me veprimin e saj, ajo edhe i shenjtëroi ata, siç thekson ati Langford: “...Nëna Tereze ka punuar jo vetëm për shpëtimin e të varfërve, por edhe për shenjtërimin e tyre, domethënë për shndërrimin e tyre të plotë, me qëllim që të përmbushet plotësisht potenciali i tyre dhe dinjiteti i tyre në Zotin”.

Për t’u thelluar dhe për ta zbërthyer veprën e Nënës Tereze, që shumë prej atyre që e njohën për së afërmi, e quajtën “*Ungjilli i gjallë*”, çdo gjë duhet lidhur me besimin e saj të patundur në Hyjin, në Birin e tij, Jezu Krishtin, dhe në lutjen, që ishte mjeti dhe burimi kryesor i jetës dhe i flijimit të saj për njeriun. Jo rastësisht ajo e pati shpallur veten “*Shërbëtorja vullnetare e vullnesës së Zotit*”.

Nëna Tereze vetë na shpalos qenësinë e jetës e të veprimit dhe të gjithë asaj që mbërriti:

“Jam vetëm një grua e varfër që lutet. Duke u lutur, Zoti më ka mbushur zemrën me dashuri dhe kështu kam mundur t’i dua të varfrit me dashurinë e Hyjit”.

Përmes lutjes Nëna Tereze i njësoi tokën dhe qiellin, konkretin dhe hyjnore; lutja i bëri të mundur të vepronte me përkushtim e me dashuri të Hyjit dhe t’i pranonte vuajtjet e njerëzve si të vetat dhe të bashkëvuante me ta.

(vazhdon në numrin e ardhshëm)

Shkruan: Daniella Radi, sociologe

Institucioni i familjes

(pjesa e parë)

Familja është institucion shoqëror i përbërë nga bashkëshortet dhe fëmijët e tyre dhe luan rol të rëndësishëm në zhvillimin dhe në formimin e personalitetit të njeriut. Fëmijët lindin në familje, edukohen dhe socializohen në të dhe kështu ata në gjirin familjar përgaditen për jetën. Familja formon karakterin e personalitetit me të cilin karakter ai do të hyjë në raporte shoqërore me të tjerët në shoqëri. Familja është një ndër konstrukcionet më komplekse shoqërore e cila qëndron dhe përbëhet prej elementeve të natyrës së ndryshme, të cilat janë me origjinë sociale, biologjike etj. Prej thurjes së funksioneve biologjike me ato shoqërore, me rregullativat kulturo-historike për gjendshmërinë ndërmjet njerëzve, rezultojnë ndërlikueshmëria e saj, që parashtron faktor dhe nuk nënçmon faktorë të tjerë, gjë që është pa vend, meqë në interpretimin e kombit duhet të merren parasysh shumë faktorë, e krejt kjo tregon ndërlikueshmërinë e kësaj çështje.

Për një kohë të gjatë mendohej se familja, madje pikërisht familja e sotme monogame, është qeliza elementare e shoqërisë. Këtë mendim e kishte Aristoteli dhe dominoi deri vonë në shek XIX, madje në disa vende të ngushta shoqërore është prezent edhe sot. Përveç filozofit të madh Aristotelit edhe sociologu Ogist Kont i cili mirret si themelues i sociologjisë, familjen e përcakton si qelizë themelore të shoqërisë. Një numër i madh sociologësh familjen e llogarisin si gurëthemel të shoqërisë, që do të thotë se shoqëria nuk mund të funksionojë pa institucionin e familjes, prandaj edhe ajo llogaritet si element kryesor i shoqërisë njerëzore. Më vonë, studimet e etnologëve të shumtë, veçanërisht të Burdahit dhe Bahofenit, i ndërruan këto pikëpamje. Bahofeni, përfaqësues i shkollës historike, themeloi pikëpamjen që më vonë e zhvilluan Morgani dhe

Engelsi, sipas së cilës familja ka karakter historik, se gjendja e parë ka qenë e karakterizuar nga promiskuiteti, prej nga rrjedh matriarkati i cili përfundimisht kalon në patriarkat.

Familja e sotme ka lindur në një fazë të vonë të zhvillimit të njerëzimit. Në të gjitha shoqëritë e pronës private e deri më sot, mbizotëron familja monogame. Vetë familja monogame sot mund të jetë si patriarkale ose konjugale. Familja monogamike patriarkale përbëhet nga burri, gruaja dhe eventualisht fëmijët dhe karakterizohet nga pozita dominante e burrit në familje. Familja monogamike konjugale është familja monogamike, por që karakterizohet nga një pozitë relativisht e barabartë ndërmjet burrit dhe gruas, barazi kjo e cila manifestohet si me lidhjen e vullnetshme të bashkëshortëve ashtu edhe në mardhënjet familjare përgjithësisht. Në botën bashkëkohore familja po pëson ndryshime të mëdha, po ndryshon karakteri, funksioni dhe pozita e bashkëshortëve dhe e fëmijëve në familje. Ky ndryshim në një anë shkon kah zhvillimi i barazisë bashkëshortore, pavarësia ekonomike e secilit prej tyre dhe kah pozita e emancipuar e fëmijëve deri te kriza e familjes dhe rritja e numrit të familjeve me një prind (nëna me fëmijët) nga ana tjetër.

Një ndarje mjaft e përhapur ndër sociologë është ajo në familje monogamike (burri, gruaja dhe fëmijët) dhe familja poligamike, të cilat prapë mund të kenë trajtën e poligenisë-kur një burrë ka më shumë gra në të njëjtën kohë dhe të poliandrisë-kur një grua ka më shumë burra në të njëjtën kohë. Familja tradicionalisht përcaktohet si një grup i bashkuar në bazë të martesës, gjakut ose adoptimit në një vatër të përbashkët për një pjesë të jetës që kanë të drejtë dhe përgjithësi ndaj njëri-tjetrit.

(vazhdon në numrin e ardhshëm)

Shkruan: Eduard Frrokaj, kandidat për master në Univerzitetin e Prishtinës



Eduard Frrokaj ka lindur me 29.06.1975 në Plançor të Gjakovës. Ka diplomuar në Shkollën e Lartë Pedagogjike në degën e gjuhës dhe letërsisë shqipe dhe në Fakultetin e Edukimit në Gjakovë. Aktualisht është kandidat për master në degën e mësimdhënies në Fakultetin e Edukimit në kuadër të Univerzitetit të Prishtinës. Me shkrime letrare dhe eseistike merret që një periudhë të gjatë. Bashkëpunon si publicist i pavarur me gazetat „Koha Ditore“, „Kosova Sot“ dhe „Zëri“. Një kohë ishte aktivist dhe kryetar i Forumit Rinor Demokristian.

Kohë e Burgosur ...

Dhoma e tregimit...

Nga dhoma shikohet liria dhe gjethet e rëna. Jashtë dhomës janë lulet dhe zërat e fëmijëve...Fëmijëve u plasën faqet nga demo(n)kracia...Në dhomë rrijmë heroik ne-bijtë e shqipes duke numëruar ditët krenar me bukë, kripë e zemër ashtu siq kemi dëshirë të themi që të ia bëjmë qejfin historisë. Kaq na mjafton për të kënaqur egon duke shikuar natyrën grit të atdheut dhe lirinë përtej dritares. Të tjerat janë luks për popullin më optimist në planetin e quajtur tokë...A na ka rënë gjaku në tokë dhe legjendë për këtë liri...Në dhomën e tregimit nuk marrim lajme të tilla...Marrim tymin e cigareve, lulet e vyshkura dhe zërat e fëmijëve...Në dhomën e tregimit është edhe kalendari i gazetave të vitit të ri që matë kohën dhe vitet që ikin...sipas kalendarit plakemi pa u bërë burra...

Burgu si metaforë...

Burgu është metaforë e trishtimit...tërë ëndrra, është si me e pa bregun e lirisë...kjo është çështja...Si jetuam të gjithë ne: i madh dhe i vogël në një liri-gjithësi dhe burg të madh të quajtur Kosovë. Nuk është fjala për Goli Otokun dhe burgjet e Millosheviqit nëpër të cilat një pjesë të jetës mizore e kaluan edhe elita politike e shqiptarëve të Kosovës. Është burgu i lirisë në Kosovën e pasluftës. Burgu më i rëndë në historinë e shqiptarëve...edhe kur po shkruaj po më vijnë nga larg fjalët „përse po shkruan kot“...„askush në Kosovë nuk lexon gazeta“...as që lodhen për gazeta dhe „shkronja pa vlerë“...është kohë e ndërtimit të villave dhe blerjes së makinave me para të buxhetit të shtetit të varfër...ky është heroizëm i kohës sonë të vranë reje...Derisa tërë këtë luks na shohin sytë, qytetari ynë jeton në burg shtëpiak pa vende pune, pa mirqënie, pa shpresa. Me duar në xhepa dhe me cigare në gojë. Plus me mendime dhe iluzione në kokë. Plus sipas të gjitha anketave „serioze“ jemi padyshim populli më optimist në botë...

8

Burgu demo(n)kratik...

Ne nuk jemi në burg. Jemi në liri të përkryer. Guxojmë të flasim, të shkojmë në qytet, të lexojmë gazeta...Tërë tregimet për mungesën e lirisë janë të stisura nga grupe „që nuk ja dojnë të mirën atdheut“...Nuk ndërrohen gjërat si me shkop magjik. Duhet të presim...Nuk e kuptojmë pra lirinë...apo më mirë, sipas këtij versioni fantazmogorik:-e kuptojmë por nuk dëshirojmë me ja ditë vlerën...Duhet të presim. Të jemi të dëgjueshëm dhe besnik para idealeve të partisë...Një njeri, sipas tregimit, e pret trenin në stacion. Treni vie me shpejtësi të madhe dhe ikë. E pret trenin tjetër. Përsëri vie me shpejtësi të madhe dhe ikë. Kur vie treni i tretë vendos që t'i dalë përballë me kusht që të ndalet. Treni nuk ndalet, por e shtyp udhëtarin „e padëgjueshëm“ në pritje, Udhëtarin nuk ia ka ditur vlerën lirisë. Është ngutur t'i dal përpara trenit „a nuk do të ishte më mirë për të dhe shëndetin fizik të priste...dhe vetëm të priste. Kështu e kishte jetuar lirinë e atdheut në pritje?“...Më mirë është të presësh apo të dalësh përpara trenit...Vërtet është dilemë e madhe...

Spaçi, mali me drita...

Burgu në të cilën jetoni ju o të padëgjueshëm të atdheut është liri, lule dhe dritë...Si nuk u kujtohet Spaçi, Burreli, malet me drita që ndriqonin natën nga klasa punëtore. Internimet, vrasjet e kulturës së kombit në Shkodër...Ky ka qenë burg eklatant sipas „mendjes gjeniale“ të diktatorit mizor Enver Hoxha...Tani tërë kjo liri për të cilën janë gëzuar fusha dhe male. Dhe dikush ngritet me i zbehë vlerat e Republikës...Duhet për të kujtuar kohën e Spaçit dhe Burrelit:-tërë ditën e lume. Tani nuk ka më male me drita nga puna vullnetare dhe heroike e klasës punëtore. Ka qytete me drita të stolitura. Pak më poshtë janë fëmijët e atdheut që të kërkojnë 10 centi për një kothere bukë...

Thyerja e mureve...

Një ditë...ajo ditë është afër-larg me mijëra kilometra nga lumturia e Republikës. Një ditë do të thyhen të gjitha muret. Do të jemi shtet demokratik në kuptimin e plotë të fjalës. Nuk do të shikohemi me tyta në istikame të luftës politike për një copë pushtet të popullit më të varfër, dhe në realitet më jo-optimist në planetin e quajtur tokë. Sa më vie keq për këtë konstatim “kuturu” që zhvlerëson anketat më serioze të bëra ndonjëherë në faqe të dheut...Është koha që të thehen muret dhe të bien dilemat. Që vota e popullit të vendosë...Edhe zogjët e malit e dinë se në Kosovë, në tërë territorin e Republikës zani po na del e goja nuk po na flet...Është koha të kthehemi në liri...Nuk besoj se ka instancë me të lartë në këtë vend se Ambasada e shtetit mik- Shteteve të Bashkuara të Amerikës së bashku me misionin European që t'i thotë stop kohës së burgosur, dhe të kthejë kohën në liri të plotë...Ne nuk mund të jemi shtet dhe nuk meritojmë të jemi shtet nëse tolerojmë mashtrimin si realitet. Për një grusht vota Kosova nuk bënë që të mbetet në kohë të burgosur...Nëse nuk e kuptojmë abc-në e demokracisë, atëherë Lavdi marrëzisë dhe kohës së burgosur...Vazhdojmë të jetojmë në shtetin më të „lumtur dhe optimist“. Nami nuk bëhet...Dhe të shkruajmë nga zemra e plasur për (pa)lirinë e atdheut...

Intervista: Ju prezentojmë ... studentin e dalluar: Agron Shala, kandidat për master në Univerzitetin e Vjenës



Agron Shala lindi në fshatin Smaq, komuna e Gjakovës në vitin 1985. Mësimet e para i mori në shkollën fillore „Atë Gjergj Fishta” në Bishtazhin, kurse edukimin e mesëm e përfundoi në Gjakovë në shkollën e mjeksisë „Hysni Zajmi”. Ai u regjistrua në fakultetin filozofik, në drejtimin e shkencave politike dhe administratës publike, që i përfundoi në vitin 2008. Tani jeton në Baden të Austrisë dhe studion në Univerzitetin e Vjenës.

1. Në cilën fazë të studimeve jeni tani?

Pasi i kam përfunduar studimet themelore në Kosovë dhe kam diplomuar. Tani këtu jam në fazën e studimeve master në drejtimin e shkencave politike.

2. A mund të konsiderohet ardhja juaj në Austri, me qëllim të formimit tuaj profesional, është një tregim suksesi?

Unë mendoj se njeriu duhet gjithmonë të jetë i ballafaquar me sfidat e jetës. Për mua ka qenë një sfidë dhe po ashtu një sukses i arritur dhe që pres në vitet e ardhshme edhe ta kurorëzoi këtë sukses.

3. Sa keni arritur të integroheni në shoqërinë austriake?

Ende nuk jam i kënaqur me vetveten, edhe pse kam krijuar lidhjet e para me njerëzit që jetojnë këtu. Por tani për tani jam në përfundim të studimeve themelore të gjuhës gjermane dhe mendoj që, pasi të filloj studimet dhe ligjëratat e rregullta, besoj që do të jetë edhe më i lehtë integrimi.

4. Sa jeni kohë të informoheni për ngjarjet politiko-shoqerore dhe kulturore në Kosovë?

Çdo mbrëmje ja kushtoi ngjarjeve në Kosovë, ku më së shumti informohem web-faqet e gazetave tona ditore.

5. Cili është libri që keni lexuar së fundi?

„Vitet e Urithit” nga Kim Mehmeti.

6. Si e kaloni kohën e lirë?

Kohën e lirë më së shumti e kaloj duke lexuar ndonjë libër apo edhe në internet artikuj dhe tema të caktuara dhe vizitoj dhe miqët.

7. A mendoni se studentët shqiptarë në Austri kanë nevojë për më shumë organizime dhe shkëmbime informacionet dhe përvojash mes vete? Si mendoni se do të arrihej një ndryshim kualitativ?

Syqyerimi im është krijimi i një qendre studentore, e cila edhe do të ishte pikëinformimi për studentet e rinjë. Ajo poashtu do të ishte edhe një qerdhe e dijes. Edhe botimi i nje reviste studentore në gjuhën shqipe është ide e mire, e ajo po ashtu do të merrej me hartimin e shumë projekteve, dhe pse jo edhe sigurimin e ndonjë burse për studentët.

8. Çfarë mendoni se duhet bërë për të rritur sasinë dhe cilësinë e aktiviteteve të shqiptarëve në diasporë?

Për të arritur sasinë edhe cilësinë, mendoj që duhet bërë një qendër për afrim dhe bashkëpunim, që do të kishte së pari pikësynim interesat e gjithë shqiptarëve që jetojnë këtu, para interesave personale.

9. Ku e shihni veten dhe duke ushtruar cilin profesion pas pesë viteve: në Kosovë, Austri apo në ndonjë vend tjetër?

Sot bota sipas konceptit modern të jetës është shumë e vogël, duke pasur parasysh instrumentet e komunikimit dhe mjetet e udhëtimit nga nje vend në tjetrin. Mendoj që do të jem në gjendje të krijoj një mirëqenie për vetveten duke u munduar gjithmonë që të jap kontribut maksimal për komunitetin ku jetoj, pa marrë parasysh vendin. Për pyetjen lidur me profesionin e ardhshëm, mendoj të jem një analist politik dhe ligjërues në fakultet.

10. Cili do të ishte kontributi juaj personal dhe profesional për fuqizimin e marrëdhënieve tradicionalisht të mira mes popullit të Kosovës dhe atij të Austrisë?

Çdo herë kur jam në shoqërinë e austriakëve mendohem që të spjegoj rreth kulturës, traditës dhe historisë së popullit tonë. Mendoj se edhe organizimi i vizitave në Kosovë të studenteve austriakë, dhe pse jo edhe përcellja e ndonjë semestri universitar në Universitetet e Kosovës nga studentët austriakë, do të ishte një mundësi e zhvillimit të miqësisë midis dy popujve. Në aspektin ekonomik, krijimi i kushteve të favorshme të kompanive austriake për investime në Kosovë do të rriste dhe fuqizonte miqësinë tonë.

Intervista: Ju prezentojmë ... studenten e dalluar: Valentina Pjetri, kandidate për master në Univerzitetin e Vjenës



Valentina P. Pjetri u lind me 12.05.1986 në Gjakovë. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Gjakovë. Pastaj në vitin 2009 përfundoi Fakultetin e Edukimit në drejtimin teknologji-informatikë. Ndërsa tani është duke vijuar studimet master në Universitetin Teknik të Vjenës në drejtimin mediat-informatikë.

1. Pse keni zgjedhur të studioni mediat-informatikë, si profesion i cili konsiderohet që ju „përket“ kryesisht meshkujve?

Është fakt që më herët ka pasur shumë pak femra që kanë studiuar në drejtime teknike. Mirëpo kohën e fundit ka pasur ndryshim të madh. Unë personalisht kam zgjedhur këtë drejtim sepse mendoj se është me perspektivë për të ardhmen.

2. Pse përzgjedhët pikërisht Austrinë që të vazhdoni studimin në shkallën e tretë-master?

Thjeshtë sepse kam synuar për një të ardhme më të mirë, duke menduar se, pas mbarimit të magjistraturës në Vjenë do të jem më e përgatitur profesionalisht.

3. Cilat ishin procedurat administrative për transferim dhe regjistrim të studimeve nga Kosova në Austri?

Sa i përket transferit tim këtu në Vjenë, jam informuar direkt nga administrata e Universitetit Teknik për kriteret e nevojshme, kështu që me kohë i kam kompletuar të gjitha dokumentet e duhura, dhe për fat të mirë, pas një afati shumë të shkurtër kohor kam marrë përgjigje pozitive.

4. Nëse krahasoni sistemet shkollore të këtyre dy vendeve, cilat do të ishin ndryshimet mes tyre?

Është fakt se edhe në Kosovë kemi kuadër shumë të mirë profesorësh. Mirëpo sa i përket drejtimeve teknike mungon praktika. Atëherë nëse bëjmë krahasimin mes këtyre dy vendeve, mund të themi se këtu në Vjenë teoria dhe praktika shkojnë paralelisht.

5. Cilat janë sfidat me të cilat ballafaqohet një student i porsaardhur në Austri?

Ka lloj-lloj vështirësish. Së pari do të thosha se sfida më e madhe është mësimi i gjuhës, pastaj mënyra e punës dhe e studimit, financimit, etj. M und të them se një student këtu mund të arrijë sukses vetëm atëherë kur është në gjendje t'i tejkaloj këto vështërsi.

6. Sa jeni të kënaqur me organizatat studentore shqiptare në Vjenë?

Të ju them të drejtën, nuk kam qasje në asnjërën nga organizatat studentore shqiptare në Vjenë. E di që ekzistojnë disa, mirëpo nga kolegët e mi që kanë ardhur më herët këtu kam dëgjuar se këto organizata deri më tani nuk kanë bërë diçka të dobishme për studentët tanë.

7. Sa jeni personalisht e angazhuar në jetën shoqërore në Austri. A jeni anëtare e ndonjë shoqate apo partie politike këtu apo në Kosovë?

Jam e angazhuar deri diku, edhe pse kam dëshirë të kem më shumë kontakte me njerëz. Por kjo nganjëherë është e pamundur për shkak të mungesës së kohës. Sa i përket partive politike, kam qenë aktive në Forumin Rinor të PSHDK-së në Kosovë, ndërsa tash jam anëtare e Degës së PSHDK në Vjenë.

8. Sa keni gjetur përkrahje nga studentët tjerë shqiptarë në Vjenë si dhe nga komuniteti ynë këtu?

Kam pasur fatin të takoj disa studentë të cilët kanë vërtet qëllime studimi. Raportet mes nesh janë shumë të mira. Ata janë gjithmonë në gjendje të na ofrojnë ndihmë kur kemi nevojë. Vetkuptohet që këtë e bëj edhe unë për ta.

9. Cilat janë planet tuaja në të ardhmen?

Sikur gjithë të rinjtë edhe une kam ëndrra dhe plane që pres t'i realizoj në të ardhmen. Mirëpo në radhë të parë dhe shumë me rëndësi për mua është përfundimi i studimeve master, ndërsa të tjerat do t'ja lë kohës.

10. Cili do të ishte mesazhi juaj për lexuesit e „Diellit Demokristian“?

Të ndajnë një kohë të shkurter për ta lexuar këtë revistë, sepse është një revistë e qëlluar këtu në diasporë. Nëpërmjet saj mund të informohemi më shumë për jetën dhe të arriturat e bashkëatdhetarëve tanë këtu në Vjenë. Kështu mund të jemi më afër njëri-tjetrit.

Intervistoi: Anita Marku

Shkruan: Mhill Marku



Mhill Marku lindi 25.01.1987 në fshatin Bërdosanë, komuna e Gjakovës. Shkollën fillore dhe atë të mesme të ulët i përfundoi në Doblibare, ndërsa shkollën e mesme të lartë në Gjakovë. Në vitin 2006 fillon studimet në Fakultetin e Edukimit në Gjakovë, në departamentin për histori dhe edukatë qytetare. Me 15 shkurt 2010, në dyzet (40) vjetorin e themelimit të Universitetit të Prishtinës ju nda çmimi-student i dalluar. Në këtë ceremoni ai përfaqësoi 1 200 studentët e Fakultetit të Edukimit në Gjakovë. Diplomoi me 12 korrik 2010 me sukses të shkëlqyer, me notën mesatare 9.62 dhe tani ka regjistruar studimet posdiplomike të shkallës së tretë-master në Prishtinë në drejtimin histori e re.

Rini-Ju Jeni Ardhmëria e Kombit

(pjesa e parë)

Ish presidenti amerikan Bill Klinton (Uilliam Xheferson Klinton) në çdo takim që kishte me të rinjtë iu drejtohet atyre me këto fjalë: "Rini ju jeni ardhmëria e vendit, ju jeni ardhmëria e botës!"

Unë do të shtoja: Rini ju jeni ardhmëria e Kombit tonë!

Nuk e di sa është e vetëdijshme rinia jonë për këtë përgjegjësi që bart në supet e veta, sa janë duke u përgatitur që sot-nesër popullin tonë ta udhëheqë në një ardhmëri më të lumtur? Mendoj se shumë pak. Përse?

Ne si komb po jetojmë në kushte dhe rrethana shumë të vështira, me një fjalë po jetojmë në kushte pa kushte. Rinia jonë që po jeton në një gjendje të mjerueshme papunësie dhe duke u ballafaquar me çdo problem dhe vështirësi, po e humb motivin për shkollim dhe duke mos parë kurrfarë perspektive në Kosovë, nuk ka tjetër qëllim përveç Perëndimit.

Një ditë në bisedë me disa të rinjë (moshatar të mi) njëri prej tyre me tha: "Jeta jonë po kalon në mjegull e paqartësi". Me një fjalë po jetojmë as në tokë e as në qiell. Sepse e përditshmja jonë ka të bëjë vetëm me gjëra te liga si me vjedhje, prostitucion, burgosje madje edhe me vrasje dhe me ambicje personale gjë që është shumë e dëmshme për rinin dhe popullin tonë shqiptar.

Ndaj ç'mund të thuhet më tepër për jetën tonë rinore?

Jemi shpërndarë në të katër anët e botës si kope. Kopeja e shpërndarë është ushqim i gatshëm për armikun. Pa dyshim ky i ri ka plotësisht të drejtë, mirëpo a janë pyetur ndonjëherë ata që kanë braktisur Kosovën Nënë: Kujt po ia lënë atë? Ku po e lënë dashurinë e Kosovës? A thua nuk iu kujtohen fjalët e shkrimtarit dhe rilindasit tonë të njohur Sami Frashërit se "Gjërat më të shtrejta në botë janë nderi dhe atdheu". A thua po harrojnë se jemi një popull autokton dhe këtu e kemi vendlindjen, se në këto troje kanë lindur paraardhësit tanë, kemi lindur ne dhe do të lindin fëmijët tanë. Rini secili prej nesh duhet të këtë një dashuri të pastër dhe të shëjtë për atdhe. Shkrimtari ynë i njohur Marin Barleci na mëson se "Dashuria për atdhe ia kalon çdo dashurie tjetër". E ne ku po e dergojmë këtë dashuri të Kosovës, në cilin vend? A thua nuk e dimë se do të ishte fatkeqësi kombëtare, që me shpërngulje të tilla të humbin të drejtën si popull para të drejtës si shtet, për të cilin ranë aq shumë dëshmor? Sikur po harrojmë se gjyshërit dhe stërgjyshërit tanë, por edhe ne vetë derdhëm gjakun që Kosova të mbetet e Jona!!!

Rini tani Kosova është e jona. Të punojmë me nder dhe me moralin më të madh për të. Të ngrisim moralin tonë si paraardhësit tanë që kishin një moral të shëjtë për këtë vend. Sipas disa shënimeve jeta morale në Kosovë sot sigurisht edhe për shkak të rrethanave në të cilat po jetojmë, ka rënë dhe po bjen gjithnjë e më tepër! Në bazë të këtyre të dhënave mund të themi se jeta morale në Kosovë shumë pak dallon prej asaj në Perëndim! Si është e mundshme një gjë e tillë?

Mjerisht edhe neve shqiptarëve na ka kapluar mentaliteti konsumizmi (merre, përdore, hudhe) si në Perëndim dhe ai i kënaqësisë trupore gjë që negativisht po jeton në jetën morale.

Sot rinia jonë por edhe të tjerët e kanë përzier shkallën e vlerave. Sot qëllimi ynë kryesor është bërë që të kemi më shumë pasuri që të tjerët t'na ç'mojnë nga kjo pasuri. Rilindasi ynë i njohur Naum Veqilharxhit thotë se "Njeriu nuk duhet të ç'mohet nga pasuria por nga dituria dhe virtytet që ka". Rini duhet te arsimohemi për të na ç'muar nga dituria e jo nga pasuria, sepse nese të tjerët na ç'mojnë nga pasuria e nuk jemi të ditur nuk vlejme asgjë, këtë po e them me plotë të drejtë duke u bazuar edhe në fjalët e shkrimtarit tonë të njohur Sami Frashërit se "Dituria është ajo që e bëri njeriun të quhet njeri". Dhe qëllimi tjetër kryesorë është të argëtohem sa më tepër, e jo që të jemi më të mire, më të ndershëm, më intelektualë, më të kulturuar etj.

Çdo ditë në shtypin tonë po lexojmë për daljen e revistave të reja erotike, për rritjen e prostitucionit, e si pasojë e gjithë kësaj edhe për abortet e shumta

Ne shqiptarët ende e kemi natalitetin më të lartë në Evropë dhe mortalitetin më të ulët. Nga historia e jonë e përgjakshme por edhe e lavdishme, e dimë se mu ky fakt na ka shpëtuar nga asimilimi.

E sot nënat tona të reja në kushte ekonomike shumë më të mira se përpara nuk dëshirojnë më shumë se tre fëmijë. Por çka është edhe më shqetësuese, për shkak të jetës së shfrenuar seksuale rritet numri i vashave të reja që abortojnë. Rini aborti është krimi më i madh njerëzorë. Mons. Dodë Gjergji thotë se "Aborti është krim brenda familjes, një nënë nuk mund të për zgjedhë që një fëmijë ta vrasë në krakror, e tjetrin ta mbajë për dore". Ndërsa Papa Gjon Pali II thotë: "Në çfarë do mënyre dhe kohe që të kryhet, që nga ngjizja e deri në lindje, aborti i qëllimshëm është vrasje e drejtpërdrejtë e një qenie njerëzore në fazën fillestare të ekzistencës së tij".

(vazhdon në numrin e ardhshëm)

Shkruan: Shtjefën Daka, magjistër i shkencave politike në Univerzitetin e Vjenës

Siguri apo paqe e ftohtë?!

Kur Thomas Hobbes shkroi veprën „Leviathan”, ai në atë kohë kishte humbur besimin tek qenja njerëzore. Në studimin e tij ai thoshte, se në gjendjen e ligjeve natyrore situata është „lufta e të gjithëve kundër të gjithëve“. Poashtu edhe më vonë realistët e përdorën këtë term, por duke ja përshtatur gjendjes politike në sistemin funksional politik të marrëdhënieve ndërkombetare, duke e mbrojtur tezën, se „qëllimi i çdo shteti është rritja e fuqisë dhe e sigurisë“.

Pra, në çdo shoqëri ekziston potenciali i dhunës, siq kishte predikuar Hobbes, dhe dhuna mund të përdoret si veprimtari apo resurs për të arritur diçka. Pra çdo njeri e ka potencialin të jetë agresor apo të shndërrohet në viktimë.

Wimmer, një profesor në Univerzitetin e Vjenës, duke u bazuar në Luhmann thotë ka disa lloje të dhunës, por më me rëndësi është të dihen shkallët e sigurisë.

Në Kosovën e pasluftës ka pasur dhe ka ende disa lloje të dhunës në shoqëri nëpër disa sisteme funksionale, por nuk ka shumë shkallë dhe alternativa apo plane të sigurisë.

Të marrim një shembull:-Verium e Kosovës. Dhuna që ndodhë dhe ka ndodhur atje ka një karakter të pastër fizik. Dhuna fizike ka si qëllim dëmtimin e trupit të njeriut dhe lidhet drejtpërdrejt në realitetin psikik-social. Në këtë rast prek integritetin personal, si p.sh.: vandalimi i serbëve të veriut, ku shkatërruan pasurinë e qytetarëve tjerë dhe poashtu thyen rregullat e rendit dhe ligjit. Kjo thyerje e rregullave është e sanksionueshme dhe duhet të dënohet. Në këtë rast dhe në këso lloj rrëmujash vihet në pikëpyetje autoriteti i institucioneve legjitime.

Siguria e qytetarëve është një ndër prioritetet themelore të një shteti. Edhe vet Hobbes aso kohe vuri në pah se, pa një kontratë shoqërore e cila do të jepte monopolin e dhunës një autoriteti të besuar nuk kishte për të pasur siguri. E këtë të drejtë institucionet e Kosovës tashmë e kanë, por jo ta përdorin në maksimum dhe pa kontrollë, por të përpilojnë planet dhe të funksionalizojnë ligjin vendor duke vendosur shkallë të ndryshme të sigurisë.

Kjo paqe e ftohtë është e rrezikshme, sespe kemi shembullin në Oseti dhe Abkazi, ku pas ndërhyrjes së autoritetit të shtetit, me ç'rast institucionet legjitime bënë përpjekjs për të normalizuar situatën dhe të vendosin rendin dhe ligjin sipas principeve kushtetuese, pati një ndërhyrje nga pala e tretë (Rusia) e cila ishte shumë më e përgatitur ushtarakisht dhe ende mbron dhe legjitimon këtë dhunë duke bërë propagandë dhe akuza ndaj përfaqësuesve të Kosovës se kinse nuk i mbrojnë të drejtat e minoriteteve.

Duke shikuar në analogji rrjedhojën e ngjarjeve në Kosovë, si dhe rezultatet të cilat dalin nga kjo mospërfillje e autoritetit të shtetit, ka ardhur tek kjo gjendje,e e cila tashmë është transformuar në një farë forme në të drejtë zakonore, e cila në shoqëritë moderne nuk ka shumë vend, por e cila mund të pamundësojë që Kosova të funksionoi si një shtet ligjor që ka territorin, sovranitetin, autoritetin dhe legjitimitetin e vet.

Shkruan: Gegë Lleshi, Gjakovë

Heshtja

Unë desha të flas për një problem që e ka kapluar popullin tonë. Pse me heshtje edhe atëherë kur është shumë e nevojshme për me folë, e sidomos me vepruar? Njeriu nuk duhet me heshtë kur shkelet e vërteta, e cila është duke u shkelur çdo ditë, por duhet me e kërkuar të vërtetën pa u ndalur deri sa ta arrijmë qëllimin e shëndoshë. Duhet me folë dhe shumë me punuar dhe t'i shërbejmë të vërtetës, sepse e vërteta i shërben çdo individ apo popull që dëshiron të ardhme. Vetëm e vërteta, puna dhe fjala e mundin heshtjen.

Njeriu nuk duhet me heshtë kur i shkelet identiteti, i cili po shkelet çdo ditë, por duke e mbrojtur me dëshminë e veprës dhe argumentit pa u ndaluar në asnjë çast duhet me vazhdu me i treguar botës se kush ishim, se kush jemi dhe se kush do të jemi edhe në të ardhmen.

Njeriu nuk duhet me heshtë ku sheh vepra të liga që po ndodhin për çdo ditë, por duhet me u përballuar me të keqen dhe duhet me mposhtur atë me veprën dhe punën e mirë. Sepse e mira i shërben jetëgjatësisë se një populli. Njeriu nuk duhet me heshtë kur i shkelet liria e fjalë dhe veprës, e cila po shkelet për çdo ditë, por duhet me e ngritur zërin. Ku dëgjohet dhe ku nuk dëgjohet-deri në lirinë e plotë.

Pra, unë mendoj se çdo Demokristian duhet të jetë shembull se si mbrohet e Vërteta, Identiteti, Vepra e Mirë dhe Liria.

Femra dhe emancipimi

Viteve të fundit ka pasur ndryshime rrënjësore që kanë përfshirë të gjithë shoqërinë kosovare, ndryshime këto të cilat nuk ka se si të ndodhin pa vështërsi e pa dhimbje. Kosova është vend i vogël i paradokseve të mëdha. Kjo duhet pranuar dhe si rrjedhojë e ndryshimit ku kemi edhe një polarizim të një pjese të shoqërisë drejt ekstremeve.

Kohët e fundit është evident fakti se edhe femrat tona, në numër të madh, shkollohen nëpër univerzitetet vendore dhe ato ndërkombëtare anë e kënd botës, gjë që është një fenomen shumë pozitiv. Por unë do të doja të ndalesha në ndryshimin që ka pësuar femra shqiptare, apo në atë që ne sot e quajmë „emancipim” apo „modernizim”, gjithmonë nëse mund të quhet i tillë.

Sot shpesh flitet për emancipimin dhe integrimin e femrës në shoqërinë moderne. Shohim femra të angazhuara në shoqata, i takojmë në konferenca e simpoziume ku ato kontribuojnë me qëllimin të arritjes së një roli dhe pozite të barabartë në shoqëri. Por në të vërtetë një pjesë e realitetit flet edhe ndryshe.

Shumë njerëz mendojnë se femra shqiptare sot është me e emancipuar se kurrë më parë. Mirëpo une nuk jam dakord me disa zëra që emancipimin e kanë kuptuar në mënyrë të gabuar.

Femrat shqiptare sot poashtu i sheh duke ecur në rrugë sikur sapo kanë dalë nga një sfilatë mode, i takon duke u katandisur nëpër kafiteri, duke u përkujdesur më shumë për paraqitjen e jashtme se sa atë të mbrendshme-shpirtërore, duke frekuentuar dhe „vizituar“ institutet e bukurisë e kirurgët e ndërhyrjeve plastike. E këtë s’mund ta quajmë „emancipim”.

Unë mendoj se ky fenomen ka një emër dhe ajo është gjysmë-lakuriqësi: gjysmë-lakuriqësi e adoloshenteve të reja në shkolla e vende publike dhe e grave dhe e vajzave në zyra e vende të punës, duke tejkaluar çdo lloj normë etike. Këto sjellin përpara nesh një zinxhir të gjatë, i cili fillon tek zhveshja trupore e shpirtërore dhe mbaron tek divorcet bashkëshortore dhe problemet familjare.

Prandaj, une do u bëja thirrje femrave shqiptare që përveq kujdesjes që tregojnë ndaj imazhit të jashtëm, të investojnë më shumë për të treguar vlerën e tyre të vërtetë, jo thjesht si një ikonë dhe trofe e bukur në krah të mashkullit, por si një shoqe jete e aftë për të marrë përgjegjësi, për të zgjidhur situata dhe për të edukuar brezin e ri, i cili do jetë pasqyra e vërtetë e ndryshimit dhe emancipimit të shoqërisë shqiptare në përgjithësi.

Thuaj po shtetit

Prolog

Me mijëra vite udhë u bënë për të ardhur deri tek data 17 shkurt 2008 dhe shpallja e pavarësisë së Kosovës. Në vitet që po jetojmë, dhe në disa të tjera që po vijnë, do përcaktohet fati i ardhshëm i saj, ndoshta dhe për mijëra vite të tjera.

Aktor dhe jo spektator

Në kohën kur procesi i njohjes së pavarësisë ka hyrë në një fazë të re, të quajtur edhe si „ritëm me shpejtësi breshke“, secili prej nesh mundet dhe duhet të jetë ambasador i shtetit më të ri në planet, sepse stagnimi mund të sjellë pasoja negative në realizimin e kësaj objektive. Ashtu si në vitet që lamë pas, kur ishim ushtar besnik të qëndrësës, sot duhet të jemi promotorë të shtetësisë sonë të re, çdokund ku jemi.

Mes aktivitetit pasiv dhe pasivitetit aktiv

Një ndër deficitet kryesore të demokracisë është dhe fakti se jo gjithmonë zgjidhen më të mirët, më të përgatiturit dhe më të përkushtuarit. Duke ditur se jetojmë në një vend ku politika kryesisht ndërtohet me premtime, ata që i bëjnë ato bazohen jo në parimin që thotë se „premtimet janë premtime“, por në atë se „premtimet mbesim premtime“. Në po këtë vend duket se opozita e vërtetë nuk gjendet në parlament por jashtë saj (në duart e atyre që „vendosin vet“) atëherë mund të ndodhë që të ketë një ndarje detyrash në kuptimin se vendimet do të merren nëpër ndërtesa institucionale, ndërsa veprimet në rrugë. Kjo agoni do të mund të vazhdojë përdërisa opozita të jetë e kënaqur me rolin që i ka dhënë vetvetes: atë të djathit zviceran-më shumë vrima se sa djathë ...

Ikja drejt së ardhmes

Sfidat e mëdha kërkojnë njerëz të mëdhenj. Kjo gjeneratë ka pasur fatin të jetojë dhe bëjë historinë. Tani ajo ka për obligim të ndërtoj shtetin. Për vete dhe për gjeneratat e ardhshme. Një ditë, kur e sotmja të bëhet dje, le të mos turpërohemi kur të na pyesin se ku ishim kur Kosova e bë shtet dhe çfarë bëmë ne për të.

Epilog

Tash kemi rastin të ndërtojmë diçka të re. Diçka ndryshe. Unë do të jem aty. Edhe Ju sigurisht.

Shkruan: Luz Thaçi

Me rastin e 100 vjetorit të lindjes së Nënë Terezës

Telegram urimi nga Kryesia e Bashkësisë së Degëve të PSHDK-së në Gjermani

Në 100 vjetorin e lindjes së saj, sot shqiptarët kudo që janë përkulen me nderim dhe mirënjohjen më të thellë ndaj bijes së tyre më të madhe dhe më të famshme, simbolit më të përsosur të moralit dhe të emrit shqiptar: Nënë Terezës.

„Nga thirrja murgeshë katolike, vepra ime i përket tërë botës“ do të deklaronte në mënyrë të përsëritur Nëna Tereze. Prandaj sot me nderime të mëdha, në 100 vjetorin e lindjes së nobelistes shqiptare, përkulen qytetarët e të gjitha kombeve, pavarësisht nga besimet fetare, racat apo bindjet. Kjo sepse një jetë të tërë ajo ja kushtoi njerëzve të varfër. Nëna Tereze kishte besim të madh tek Zoti dhe tek Krishti të cilin e shihte të çdo njeri me përkushtim. Ajo forcën e madhe të dashurisë e shëndërroi në autoritetin moral më të fuqishëm të shekullit që jetoj.

Çdo njeri që ka pasur fatin të njohë nga afër atë mban në memorien e tij buzëqeshjen e saj, si më të ëmblën e të gjitha buzëqeshjeve njerëzore që ka takuar në jetën e tij. „Të ndihmohet dhe të kuptohet të varfërit duhet të jetosh si ata“, deklaroi ajo në fjalën e saj në ceremoninë e laurimit me çmimin Nobel për Paqe në vitin 1979.

Prandaj, ne si Bashkësi e Degëve të Partisë Shqiptare Demokristiane të Kosovës për Gjermani shprehim edhe një herë mirënjohjen tonë më të thellë bijes më të shquar të popullit tonë, dhuratës më të çmuar që Kombi Shqiptar i ka bërë njërëzimit në të gjitha kohërat: Nënës Tereze.

Luz Thaçi, kryetar i BD të PSHDK për Gjermani

Faqja historike

Shkrim i përmbledhur nga Xhenc Bezhi

Fritz Radovani: Eshtnat e At Gjergj Fishtës janë në Rëmaj!...

Një prift i ri, kur pat takue At Meshkallën dhe i tregoi se Imz. Ernesto Çoba, i kishte mësue këtij kushtet që duhet me heshtë, Mëshkalla i tha: "Shko e thuaj Monsinjorit, me të mësue kushtet që duhet me folë, se me heshtë kemi heshtë boll!...

Edhe unë, tue rikujtue porosinë e At Meshkallës, po flas, se boll kam heshtë!...

Aty rreth vitit 1980, kam shkue ndër vorre të Rëmajt me u interesue për një vorr të një familjarit tem. Kam takue të ndjerin Gjon Gjergji, ish roje e vorreve. Mbasi kemi bisedue për problemin personal, Gjoni me një dashamirësi dhe me njëfarë afrimiteti, më mori për krahu dhe u nisëm në drejtim të Kapelës së vorreve. Mbas pak minuta heshtje, më tha: "Do të shkojmë bashkë në një vend sekret, kam besim se nuk ke me folë me njeri, mbasi kjo që po të tregoj asht gjithmonë me rrezik ba me folë...". Ecëm nga ana e majtë e Kapelës, kaluam vorrët e motrave stigmatine, numroi 1,2,3,4, selvijat dhe tek e katërta, ndaloi. U afruam tek muri dhe aty më shikoi në sy dhe, më tha: "Fritz, Pashë Shpitnat e Atyne të vdekunve që ke në këte vend, dhe që, nga njohja me Ta, po të besoj edhe ty, të lutem mos me folë me asnjeri pa ardhë ajo kohë që ti ke me pasë mundësi me tregue,... se je i ri e një ditë...këtu, unë kam futë një thes çimentoje me Eshtnat e At Gjergj Fishtës...". U stepa në vend. Pak minuta nuk kemi shkëmbye asnjë fjalë. Për me sigurue kujtesën teme, kam shikue pranë vorrin e një grues së re që kishte një foto në porcelan. Kam numrued edhe njëherë selvijat dhe jemi kthye me Gjonin në drejtim të Kapelës. Aty jemi ndalue prapë. Gjoni më kuptoi mirë vetëm me të shikue me se cila mund t'ishite pyetja ime: "Si mundën me kenë në Rëmaj Ato Eshtna shumë të përfoluna dhe të "tretuna" në lumin Drin, pranë Urës së Bahçalikut?"....Më shpjegoi se: "Ka shkue në një mbasadreke, rreth orës 15.00 në shtëpi të Gjonit, ish Drejtori i Ndërmartjes që merrej me riparimin e Kinema Puntori (ish Kisha e Fretenve), i ndjeri Shyqyri Rrjollli, dhe i ka kërku me shkue për një problem urgjent në Rëmaj. Gjoni ka marrë çelësat, ka hypë në makinën e Shyqyriut dhe janë gjetë për 3 minuta aty, nga rruga Canej ku banonte Gjoni. Kanë hy me makinë deri tek Kapela, janë ndalue dhe, kanë shkue tek vendi ku kishte mendue Shyqyriu, me varrosë "thesin e çimentos". Gjoni me një lopatë ka hapë një gropë të vogël, po Shyqi, i ka marrë lopatën dhe e ka thellue ai vetë ma shumë gropën, tue shkue afro 50-60 cm. thellësi. E kanë mbulue dhe porosia ishte që Gjoni nuk duhet të fliste me asnjë person. Shyqyriu i kishte tregue Gjonit, se dikush e kishte urdhnu me i nxjerr eshtnat e Fishtës nga Kisha dhe me i tretë në lumin Drin. Shyqyriu ka urdhnu një punëtor me i futë eshtnat në thes dhe me ia çue në zyre, prej ku, mbas orarit të punës Shyqyriu do të shkonte dhe t'i hidhte në lumin Drin. Mbasi punëtori ka lanë thesin në zyre të Shyqyriut ka ikë, po Shyqyriu e kishte mbajtë thesin tri ditë në zyrë dhe kur ka vërejtë se asnjeri nuk interesohet ma për atë çeshtje, ka shkue tek Gjoni, dhe i ka besue për veprimin që kanë krye bashkë me të në vorrezat e Rëmajt".

Për këtë çështje, mbas vitit 1992, unë kam vue në dijeni tre persona, Anton Benussin, Ernest Përdodën dhe në 1995, kur po riparohej Kisha Françeskane, At Konrrad Gjollaj, i cili, mund ta ketë bisedue me At Z.Pëllumbin. Unë dhe A.Benussi jemi gjallë... tjerët jo!... Mendoj, se nuk duhet vazhdu ma mos me folë, edhe pse "demokratët" shqiptarë janë bijtë e baballarëve që kanë çvarrosë At Gjergj Fishtën. Por, tue u nisë se, ndoshta, ka mbetë ndër to një tjetër "Shyqyri Rrjoll", që asht pak e vështirë me e mendue se ka, pranova me tregue këtë sekret, për të cilin po ndodhi një përsëritje e së keqës maparshme me At Fishtën:

TURPI DO T'I MBETET VETËM SHKODRËS DHE VETËM ASAJ!

Fritz Radovani

GJERGJ FISHTËS

(në përvjetorin e harresës)

Me një kamxhik
që s'të shkonte huq,
përmbi gaça e zagar të kuq,
që gugsojshin për Anadollin,
e kangë këndojsin për Moskovin,
mbajshin në krye "kapica" e "qyla",
tjetër s'ishin, veç do bërryla,
që fryheshin barkut si bagëtia
deri sa n' gjak lahej Shqipnia.

E prap sot, që kem dy shtete,
kanë po të njëjtat muhabetë:
me ndreqë vila e karroca,
me fry barkun si bretkosa.
Brezi ynë, i vuajtun shumë,
ka 'i dëshirë që digjet shkumb:
Me ia hapë kapakun shpresës,
me heqë pluhurin e harresës,
me t' dijtë vorrin a e ke kund,
eshtnat tuja, hedhë në lum,
pse Atdheun e deshte shumë.

*Xhenc Bezhi
Salzburg, tetor 2010*


Shkruan: Prof. Mhill Shala, Gjakovë

Martirët e famullisë së Smaqit¹ (Bishtazhinit)

Fishta i madh në „Lahutën e Malcis” në vjershën Patër Gjoni shkruan:

*„Ma mir dek nen dhe m’u kja
Sa me marre gjall mbi dhe
Per dhe t’vet kush dek ka ra
Ai s’ka dekun po ka le”*

Qëllimi i prezantimit të këtij artikulli është që më pak fjalë të thuhet shumë. Ne që kemi për detyrë të mos lejojmë të shtrembërohet historia, e në qoftë se jemi të parët, me siguri nuk do të jemi as të fundit që në shenjë mirënjohje t’iu shpallim martirëve dhe t’ua bëjmë një himn lavdie. Ende janë në mendjen dhe kujtesën e njerëzve të cilët i varrosën 64 (gjashtëdhjetë e katër) martirët e vrarë nga forcat serbe. Prej tyre 12 (dymbëdhjetë) burra në të njëjtën ditë u masakruan me bajoneta në Xhaminë e Rugovës të Hasit. Familjarët e tyre edhe sot me mall i ruajnë rrobat e përgjakura të vrarëve, ndërsa 52 të tjerët u vranë në vende të ndryshme të vendbanimeve si në Marmull 11, në Kusar 8, në Smaq 7, në Dol 11, Kushavec 2, Bërdosanë 4 etj. Dëshmia e gjallë për këto vrasje të cilat u bënë në Javën e Madhe të Pashkëve katolike të vitit 1941 janë dokumenti i evidentimit për të vdekurit në librin kishtar të Kishës së Smaqit, tani e ndërtuar si kisha e re në fshatin Bishtazhin. Arkivi i Zyrës Famullitare në Bishtazhin (Gjakovë) dëshmon në dokumentin Libër: DEFUNCTORUM, Viti 1941, Nr. 28-78, fq. 94-100.



- 16 -

Kjo ngjarje tronditëse e asaj kohe u reprizua në vitin 1999 kur forcat policore, ushtarake dhe paramilitare serbe bënë kërdrinë më të madhe që njeh historia e kësaj ane. Një luftë të egër dhe të pa barabartë vrau shqiptarë nga të gjitha moshat. Ky shkrim besoi se do të jetë një shtytje për të gjithë atdhe-dashësit si edhe intelektualët dhe klerikët tanë që të fillojnë për të bërë një projekt për t’i përkujtuar këta martirë më ngritjen e lapidarëve nëpër vendet e vrasjeve, apo varrosjeve në një vend të përbashkët për të gjithë, pasi që të gjithë janë të një famullie, dhe të njëjtit i ka evidentuar edhe varrosur Don Luka, famullitari i famullisë së Smaqit, tani famullia e Bishtazhinit

Poqe se nuk aktualizohet më shpejtë projekti për t’u ndërtuar ndonjë lapidar, do të ishte mirë që në javën e muajit prill, kur bie data 11, dita kur është bërë masakra e parë dhe në vazhdimësi deri më 19 prill të mbahet një tribunë për të diskutuar dhe vendosur seriozisht për këtë gjë. E ritheksoj këtë propozim pasi që para disa viteve në famullinë tonë u vu në lëvizje kjo ide. Atëbotë u formua edhe këshilli për përgatitjen e këtij simpoziumi apo takimi, por iniciativa mbeti në gjysmë të rrugës. Pra, le të kontribuojmë që kjo të marrë jetë tani.

¹ Fshat në komunën e Gjakovës

Këndi kulturor

Shkruan: Xhenc Bezhi

URIME KRISHTLINDJEN

Ati ynë, që je në qiell,
zbrit një herë edhe ne tokë.
Nuk po njohim njeri tjetrin
s'njohim vëlla, as shokë.
Kemi dalë nga rruga jote
s'ka më dashuri
Mendojmë mirë për vete
e keq për kojshi.
Na ka hy n'mes interesi
ka humbë burrnia,
miku të rrijë në punë të vet
mos t'na vijë te shtëpia.

Zbrit në tokë e folna shqip,
na jep paqë edhe bekim,
Zot ke qene e Zot do mbetesh:
Emni yt nuk do përkthim.

Ati ynë, që je në qiell,
ti nuk je vrestartar,
Zotat tjerë të rrejshëm
sikur na mëkatarë;
Tek ti kemi shpresën.
tek ti kemi bindjen:
Populli im i dashun,
Urime Krishtlindjen.

POEMË MËRGIMI

Kush prej hallit, kush prej lakmisë,
ia kem kthye kurrizin shtëpisë,
e ia shtuem një gajle vetit:
Morëm rrugët e gurbetit.

Veç të dalim njëherë jashtë,
se krejt punët do bahen mirë,
tue mendue se qumësht e mjaltë
do t'i kemi darkë e sillë.

Po mërgimi s'asht vend lojë,
ku shkojnë njerëzit me shëtitë,
siç e shohin do nga larg -
Humb gjithçka kur humb të ritë.

Mbrapa shpine i lamë prindët,
qe n'kujtese na mbetën prore,
n'minut t'fundit s'u qemë pranë:
I lamë pleq, i gjetëm vorre.

Ka pasë thanë një plak n'kuvend
një fjalë t'urtë, që mbahet mend:
“Dheun e huej, bir,ta tregofshin,
po në te kurrë mos të çofshin.

Po na erdh puna një ditë
Vendit tanë me i thanë këtu jemi,
a do të dalë kush me na pritë?
Vend për varr, a do të kemi?

Kur vajtoret t'nisin kujen,
po u shkoi mendja me vajtua,
dy fjalë në rend a mund i venë?
Kënd ma parë kanë me mallkue?

Një qind vjet rob të Serbisë,
pa i pas borxh e pa i pas hak,
tash e mbrapa rob të lakmisë:
na ka hy si drogë në gjak.